



THE EUROPEAN UNION'S CROSS BORDER
COOPERATION PROGRAM

Projekti i financuar nga IPA CBC nën EuropeAid/170339/DD/ACT/MK

12/09/2023

Projekti: MBROJTJA NDËRKUFITARE

Zbatimi i projektit “Crossborder – Fireshield” vazhdon me aktivitetet e ndryshme të planifikuara në kuadër të zbatimit të projektit.

Sot, më 12.09.2023, në komunën Vrapçisht në Maqedoninë e Veriut, Sekretariati i Përbashkët Teknik i Programit mbajti takim monitorues me përfaqësuesit e partnerëve të projektit: komunat Vrapçisht, Bogovinë dhe Cërrik dhe Caritas Shqipëri. Takimi u fokusua në vlerësimin e gjendjes aktuale të projektit dhe aktivitetëve të ndërmarra nga secili partner i projektit.

Qëllimi i takimit ishte që të shtjellohet zbatimi i Planit të Veprimit të projektit deri më tani, të bëhet analiza dhe të diskutohet ecuria e projektit dhe sfidat e hasura.

Në fund të takimit është bërë një vizitë në kantierin ku po ndërtohet zjarrfikësja për komunën Vrapçisht dhe Bogovinë, si mjet kyç që do t'i përgjigjet nevojave të komunitetit për mbrojtje nga zjarri në raste emergjente.

Ky projekt financohet me thirrjen IPA II, CBC, Europe Aid/170339/DD/ACT/MK



Implemented by:



Caritasi i Shqipërisë së Jugut
Cërrik - Ferme



THE EUROPEAN UNION'S CROSS BORDER
COOPERATION PROGRAM



Implemented by:



BASHKIA CERRIK



Caritasi i Shqipërisë së Jugut
Cerrik - Ferme